



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 152

Tiranë – E premte, 28 korrik 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 554, datë 24.7.2017	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	7251
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 89, datë 7.6.2017	Mbi fillimin e procedurës “Për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era”.....	7252
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 104, datë 10.7.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “EFT Tërana” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7254
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 105, datë 10.7.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Ayen As Energy” sh.a., për modifikimin e licencës së “Prodhimit të energjisë elektrike” me nr. 273, seria PV15K, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015.....	7255
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 106, datë 10.7.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Mesmal 1”, me fuqi të instaluar 410 kw; “Mesmal 2”, me fuqi të instaluar 1 473 kw; “Mesmal 3”, me fuqi të instaluar 235 kw; “Selca 2”, me fuqi të instaluar 2 388 kw dhe me fuqi totale të instaluar 4 506 kw, për një afat 30-vjeçar.....	7256
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 107, datë 10.7.2017	Mbi fillimin e procedurave për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017, për shoqërinë OST sh.a.....	7257
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 108, datë 10.7.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Skatina HEC” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Skatina”, me fuqi të instaluar 2677 kw.....	7257
Kërkesë e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë nr. 3072/6, datë 20.7.2017	Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore, arë, truall, pyll, kullotë”, që preken si rezultat i krijimit të perimetrit të sigurisë fizike të objekteve me rëndësi strategjike të godinave të Qendrës Kombëtare Dispeçer, Zyrrave të reja të OST sh.a. dhe Dispeçerisë Qendrore, Kashar.....	7258

Kërkesë e e Ministrisë së
Energjisë dhe Industrisë
nr. 4002/1, datë 20.7.2017

Për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit
“tokë bujqësore, arë, truall, pyll, kullotë”, që preken nga “Ndërtimi i
linjës 110 kv, Memaliaj - Gjirokastër, shtylla lidhëse me
nënstacionin”

7260



VENDIM

Nr. 554, datë 24.7.2017

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT
KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË PARTISË
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, NË
QARKUN FIER, PËR PLOTËSIMIN E
VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA
KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 24.7.2017, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri	kryetar
Denar Biba	zëvendëskryetar
Bledar Skënderi	anëtar
Edlira Jorgaqi	anëtare
Gëzim Veleshnja	anëtar

shqyrtoi çështjen me

Objekt: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas përfundimit të mandatit të deputetit, z. Arben Çuko.

Kërkues: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Nëpërmjet shkresës nr. 1867/1 Prot., datë 20.7.2017, drejtuar KQZ-së, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit z. Alban Brati, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Arben Çuko, deputet i zonës zgjedhore qarku Fier.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 29, datë 2.8.2013, ka shpërndarë mandatet dhe ka

përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore qarku Fier, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste e Shqipërisë për zonën zgjedhore qarku Fier, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 qershor 2013, ka fituar 9 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë për qarkun Fier është si më poshtë: me numër rendor 1 (një), z. Gramoz Kaso Ruçi; 2 (dy), z. Erion Mirdash Braçe; 3 (tre), znj. Eglantina Muharrem Gjermani; 4 (katër), z. Ilirjan Hyda Celibashi; 5 (pesë), z. Armando Subashi; 6 (gjashtë), z. Arben Kristaq Çuko; 7 (shtatë), z. Piro Dano Lutaj; 8 (tetë), znj. Majlinda Daut Bufi; 9 (nëntë), z. Ervin Agim Koçi.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancave të njëpasnjëshme, për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Ilirjan Hyda Celibashi, znj. Eglantina Muharrem Gjermani, znj. Majlinda Daut Bufi, z. Armando Nikolla Subashi, deputetë të zonës zgjedhore qarku Fier, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin 228, datë 7.5.2015, i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Bujar Avdulla Çela.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë në qarkun Fier i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës. Gjithashtu konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, fjalia e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Socialiste të Shqipërisë në zonën zgjedhore qarku Fier.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane”, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë për 12 zonat zgjedhore.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 102, datë 29.3.2017, “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë në



qarkun Fier, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë”, ka vendosur t’i japë mandatin e deputetit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë qarku Fier, kandidatit me numër rendor 12 (dymbëdhjetë) z. Xhevit Qemal Bushaj.

Sipas listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë për qarkun Fier, kandidati i radhës është kandidati me numër rendor 13 (trembëdhjetë), z. Artur Hasan Çobani.

Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezultoi se personit të cilit do t’i kalojë mandati si deputet për në Kuvendin e Shqipërisë, nga lista shumemërore, për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga ndërprerja e mandatit të z. Arben Kristaq Çuko, është z. Artur Hasan Çobani, i cili renditet përkatësisht me numër rendor 13 (trembëdhjetë).

Referuar nenit 11 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Z. Artur Hasan Çobani depozitoi formularin e vetëdeklarimit në KQZ, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, deputet i Kuvendit.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Artur Çobani rezultoi se nuk është deklaruar asnjë e dhënë që ka të bëjë me kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Sipas informacionit të ardhur me shkresën nr. - 3244/1, datë 21.7.2017, nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, në KQZ, rezultoi se z. Artur Hasan Çobani kandidat për deputet në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Fier, është i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Artur Çobani dhe informacionit të ardhur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, Tiranë, rezultoi se nuk ka të dhëna që të përfshihet në kushtet e ndalimit të zgjedhjes në funksionin e

deputetit, sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës, i renditur me numër rendor 13 (trembëdhjetë) në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë në zonën zgjedhore qarku Fier, z. Artur Hasan Çobani.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë qarku Fier, z. Artur Hasan Çobani.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

VENDIM

Nr. 89, datë 7.6.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS “PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA, TË RINOVUESHME NGA DIELLI DHE ERA”

Në mbështetje të nenit 10 dhe 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 10, pika 3 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era”, nenit 19 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij



të datës 7.6.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike, në lidhje me fillimin e procedurave “Për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era”,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era, në bazë të nenit 10, pika 3 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

- Në pikën 1 të nenit 10 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” parashikohet se: “Mbështetja sipas kontratës për diferencë nuk zbatohet për prodhuesit me përparësi: a) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 MW; b) me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 MW për energjinë e erës; c) për projektet demonstruese.”

- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era” shprehet se: “Ligji i ri (7/2017) parashikon vendosjen e tarifave FIP (*Feed-In-Premium*) me anë të një procesi konkurrues, jodiskriminues të tenderimit (ankande) nëpërmjet Kontratave për Diferencë (CfD), ndërsa instalimet e reja mbi 2 MW përjashtohen nga procesi konkurrues me çmimin tavan, që do të vendoset bazuar në këtë metodologji.

- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era” në pikën 2 të përfundimeve shprehet: “Mbështetur në ligjin 7/2017, neni 10, pika 3, Enti Rregullator i Energjisë do të miratojë çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla,

të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017 sipas parashikimeve të kësaj metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së mësipërme për sa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim”.

- Mbështetur në nenin 10, pika 3 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e tjerë me përparësi, e cila duhet të përcaktojë kriteret e llogaritjes së çmimit, bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve sipas llojit të teknologjisë së përdorur. ERE përcakton çmimin bazuar në kriteret e përcaktuara te kjo metodologji.

- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era”, nuk është hartuar në formën që duhet të ketë një metodologji, por si një material shpjegues që konkludon me përcaktimin e çmimit për vitin 2017, atribut që, siç shpjeguar më sipër, referuar ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, e ka ERE, e cila në çdo rast, për qëllime të përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga çdo prodhues tjetër me përparësi, vepron në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Vendosja e një çmimi blerjeje për impiantet e vogla vetëm për vitin 2017, nuk mund të shërbejë për të nxitur investimet në këto lloj burimesh të vogla, të cilat duhet të kenë një perspektivë afatgjatë të kthimit të investimit.

- Sa më sipër, vendosja e këtij çmimi në metodologji i shërben më shumë qëllimit të kryerjes së tenderimit të impianteve që përfitojnë mbështetje nga kontrata për diferencë.

- Konstatohet gabim i dukshëm në llogaritjen e çmimit për vitin 2017 në tabelën bashkëlidhur me vendimin të miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era”. Llogaritja e çmimit



rezulton të jetë e bazuar në LCOE(kosto e niveluar e energjisë) dhe WACC. Bazuar në shifrat e evidentuara në tabelë, për periudhën 2017-2019 LCOE e PV (foto voltaikët) është më e lartë se LCOE e erës, ndërsa WACC rezulton i njëjtë.

- Sa më sipër do të gjeneronte një çmim më të lartë për energjinë e prodhuar nga era sesa energjia e prodhuar nga dielli, por tabela tregon të kundërtën.

- Janë konstatuar paqartësi në lidhje me referencat orientuese në llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era, mes VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era” dhe ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës “Për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era”.

2. T’i kërkohet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë sqarim dhe saktësim i referencave të kuadrit ligjor rregullator, për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla, të rinovueshme nga dielli dhe era.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 104, datë 10.7.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “EFT TIRANA” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” e “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EFT Tirana” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria “EFT Tirana” sh.p.k., me shkresën nr. 470 Prot., datë 23.6.2017, ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “EFT Tirana” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat (“a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “EFT Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 105, datë 10.7.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “AYEN AS ENERGY” SHA,
PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
“PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE” ME NR. 273, SERIA PV15K,
TË MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S
NR. 32, DATË 4.3.2015**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; VKM-së nr. 365, datë 4.5.2011, “Marrëveshje kocensionare me nr. 5446 Rep.; nr. 1944 Kol., datë 2.5.2011”, të ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neni 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për modifikimin e licencës së shoqërisë “Ayen As Energy” sh.a., për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen As Energy” sh.a. është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gojan”, “Gjegjan”,

“Peshqesh” dhe “Fangu” me fuqi totale të instaluar 110.54 MW, me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015.

- Shoqëria “Ayen As Energy” sh.a ka nënshkruar një kontratë shtesë të koncesionit me nr. 217 Rep., nr. 68/1 Kol., datë 20 janar 2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT”, kontratës koncesionare nr. 5446 Rep., nr. 1944 Kol., datë 2.5.2011; ndryshuar për sa vijon: “Të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentraleve të Peshqeshit, Ura e Fanit, Fangut, me një fuqi totale 109.71 MW”.

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Ayen As Energy” sh.a., në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezulton si më poshtë:

- Neni 9, pika 1, germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (të dhëna për aplikuesin) pa plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës; plotësuar.

- Germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës; pa plotësuar.

- Germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera; plotësuar.

- Germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi; plotësuar.

- Germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE, plotësuar.

- Nga HEC-et “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh” dhe “Fangu”, të dhëna me koncesion subjektit “Ayen AS Energy”, janë hequr HEC-et: “Gojan” dhe “Gjegjan” dhe është shtuar HEC-i i ri “Ura e Fanit.”

- Ka ndryshuar fuqia e instaluar e HEC-eve të dhëna me koncesion më herët e për të cilat ERE është shprehur me vendim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “Ayen As Energy” sh.a., dhënë me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015, me nr. 273, seria PV15K për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e “Gojanit”, “Gjegjanit”, “Peshqesh”, “Ura e Fanit” dhe “Fangu”, me fuqi totale 110.54 MW, në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit me nr. 217 Rep., nr. 68/1 Kol., datë 20 janar 2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT”, kontratës koncesionare nr. 5446 Rep., nr. 1944 Kol., datë 2.5.2011.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 106, datë 10.7.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJIA VALAMARA” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “MESMAL 1”, ME FUQI TË INSTALUAR 410 KW; “MESMAL 2”, ME FUQI TË INSTALUAR 1 473 KW; “MESMAL 3”, ME FUQI TË INSTALUAR 235 KW; “SELCA 2”, ME FUQI TË INSTALUAR 2 388 KW DHE ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 4 506 KW, PËR NJË AFAT 30-VJEÇAR

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të Faqe|7256

“Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat (“a”, “b”, “c”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gerrat “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 dhe 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me nenin 9, pika 2, gerrat “d” dhe “e”, nenin 9, pika 3, gerrat “a” dhe “c”, nenin 9, pika 4.1.5, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, neni 11, pika 1, t'i paraqesë ato në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë nga HEC-et “Mesmal 1”, me fuqi të instaluar 410 kw; “Mesmal 2”, me fuqi të instaluar 1 473 kw; “Mesmal 3”, me fuqi të instaluar 235 kw; “Selca 2”, me fuqi të instaluar 2 388 kw dhe me fuqi totale të instaluar 4 506 kw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

**VENDIM
Nr. 107, datë 10.7.2017**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR VITIN 2017, PËR
SHOQËRINË OST SHA**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, geramat “a” dhe “e”; neni 60, pika 4 dhe 5; neni 110, pika 2 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe neni 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009; “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 62, datë 15.9.2009; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017, për shoqërinë “OST” sh.a., të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, konstatoi:

- Me anë të shkresave nr. 774, datë. 3.11.2016 dhe nr. 275, datë 30.3.2017, ERE ka kërkuar paraqitjen për miratim të planit të investimeve për vitin 2017.

- OST sh.a., me anë të shkresës nr. 274/1, datë. 3.3.2017, ka paraqitur në ERE tabelën e planit të investimeve për vitin 2017, të miratuar nga këshilli mbikëqyrës.

- Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim konstatoi që ajo nuk mund të konsiderohet kërkesë për miratimin e planit të investimeve për vitin 2017, në kuptimin e parashikimeve të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 62, datë.15.9.2009.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin planit të investimeve për vitin 2017 për shoqërinë “OST” sh.a., me kusht që shoqëria të depozitojë në ERE, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e këtij vendimi, aplikimin sipas kushteve të parashikuara në “Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

**VENDIM
Nr. 108, datë 10.7.2017**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“SKATINA HEC” SHPK NË AKTIVITETIN
E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “SKATINA”, ME
FUQI TË INSTALUAR 2677 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5, germa “a”; 13 dhe 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe neni 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.7.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Skatina HEC” sh.p.k., si dhe informacionin shtesë të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Skatina”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin me nr. 32, datë 9.3.2016, filloi procedurat për licencimin e shoqërisë “Skatina



HEC” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Skatina” me fuqi të instaluar 2677 kw.

- Në mbledhjen e bordit të ERE-s, datë 19.4.2017, është evidentuar dokumenti i paplotësuar nga kjo shoqëri “Miratimi i pikës së lidhjes”.

- Shoqëria “Skatina HEC” sh.p.k., me shkresën nr. 110 Prot., datë 7.6.2017, ka paraqitur dokumentacionin plotësues si më poshtë:

- Miratim pikë lidhje “Skatina HEC” me nr. 1236/3 Prot., datë 24.5.2017.

- Marrëveshja e Lidhjes së Re me nr. 1236/2 Prot., datë 24.5.2017.

- Aplikimi i shoqërisë “Skatina HEC” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Skatina HEC” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Skatina”, me fuqi të instaluar 2677 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative, brenda 30 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË Nr. 3072/6, datë 20.7.2017

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore, arë, truall, pyll, kullotë”, që preken si rezultat i krijimit të perimetrit të sigurisë fizike të objekteve me rendësi strategjike të godinave të Qendrës Kombëtare Dispeçer, Zyrrave të reja të OST sh.a. dhe Dispeçerisë Qendrore, Kashar.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: “OST” sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme. Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË ENERGJISË DHE
INDUSTRIË
Koli Beke



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT NDËRTESA E RE E OST SHA, QENDRA DISPEÇER DHE SIGURIA E QENDRËS DISPEÇER

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë bujqësore, arë

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë bujqësore

Lloji i pasurisë së kulturës bujqësore që dëmtohet

Nr.	Pronësia										
	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit m ²	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera në lekë	Shënime
Bashkia Tiranë											
Njësia administrative Kashar											
1	Rexhep	Shaban	Sula	Arë	2105	1/15	7375	3043	448	1,363,264	Kashar, Tiranë
2	Rexhep	Shaban	Sula	Arë	2105	1/18	4437	2196	448	983,808	Kashar, Tiranë
Shuma								5239		2347072	

Sipërfaqe totale shpronësimi 5239 m²

Vlera totale e shpronësimit 2347072 lekë

**KËRKESË****Nr. 4002/1, datë 20.7.2017****PËR SHPRONËSIM ME INTERES
PUBLIK**

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore, arë, truall, pyll, kullotë”, që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kv, Memaliaj - Gjirokastër, shtylla lidhëse me nënstacionin”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: “OST” sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i

Shpronësimi, pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme. Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË SË ENERJISË DHE
INDUSTRIË
Koli Beke**



LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SHTYLLËS NR. 95A TË LINJËS 110 KV MEMALIAJ - GJIROKASTËR

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: truall, arë

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Pronësia					Shënime
						Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e pronës m ²	Sipërfaqja e shpronësimit m ²	Çmimi i tokës lekë/m ²	Vlera në lekë	
Bashkia Gjirokastrë											
Gerhot -Virua											
1	Mesemi	Karafil	Rrapa	Truall	8541	193/6	1520	43.6	4865	212,114	
Shuma								43.6		212114	

Sipërfaqe totale shpronësimi 43.6 m²

Vlera totale e shpronësimit 212114 lekë

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 112 lekë